



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 365/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Ymer Hoxha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën, e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në lidhje me shkeljen e Rregullës Nr.11/2009-Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në seancën e mbajtur me datë 11.12.2010 mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar.

ARSYETIMI

Më 09 Dhjetor 2010, (PZAP) ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR, në të cilën pretendohet se subjekti politik PDK me datë 08.12.2010 në rrugën Luan Haradinaj, kandidati për deputet nga rradhët e PDK-së Memli Krasniqi, ka bërë shkeljen e kodit të mirësjelljes duke mbuluar me posterat e tij, posterat e kandidatit për deputet nga rradhët e Koalicionit për Kosovën e Re, Selami Gashi, duke shkelur në këtë mënyrë Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës nëni 33 pika (a) dhe Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 nëni 3.1 pika (a).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotokopjen e fotos si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

Ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 3.6, pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP parashihet si vijon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Neni 3.6 “Te gjitha ankesat duhet te kenë se paku informacionet vijuese:c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit”

Duke i shqyrtuar faktet e paraqitura nga pala ankuese, PZAP konsideron se ankesa në fjalë ka mungesë të provave të mjaftueshme dhe të pranueshme për t’u bindur se Memli Krasniqi kandidat për deputet nga PDK ka mbuluar posterin e kandidatit të Koalicionit për Kosovën e Re. Fotokopja e paraqitur si dëshmi mbështetëse për rastin në fjalë, nuk krijon mundësinë për të vërtetuar shkeljen e pretenduar, pasi qe ne rastin konkret posterat e kandidateve janë te vendosur afër njeri tjetrit si dhe kandidatit për te cilin pretendohet se ju ka mbuluar posterin nuk i dihet identiteti as partiak e as personal, si dhe nuk shfaq qartë ekzistencën e shkeljes në bazë të Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a). Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 365/2010 më datën 11.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Ymer Hoxha

